

Nr: 3342 prot
Dt: 26.09.18.

S T A T U T
I
SHOQERISE ""KLUBI I FUTBOLLIT TURBINA " SH.P.K.

KREU I.

KRIJIMI FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI
NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "KLUBI I FUTBOLLIT TURBINA " SH.P.K. me seli ne Cerrik, Prane stadiumit "Nexhip Trungu" eshte krijuar sipas kontrates se ciles i bashkengjitet ky statut, dhe sot po **riformaton statutin** e saj ne perputhje me kerkesat ligjore parashikuar nga ligji 9901 dt 14.04.2008 "Per tregetaret e Shoqerine Tregtare " i ndryshuar me ligjin 10475 dt 27.10.2011 , dhe ligjin nr.9723 dt.03.05.2007 "Per qendren Kombetare te Rregjistrimit " i ndryshuar , si dhe ne ligjet e tjera qe lidhen me veprimtarine tregtare ne Republiken e Shqiperise sipas vendimit te ORTAKOVE TE SHOQERISE

NENI 2

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne perputhje me legjisacionin shqiptar ne fuqi, si dhe ne perputhje me dispozitat e ketij statuti. Shoqeria e fiton personalitetin e saj juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar te QKB .

NENI 3

Kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet dhe mund te shperbehet ne cdo kohe me vendim te asamblese se ortakeve apo me menyrat e parashikuara ne legjisacionin shqiptar

NENI 4

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj :

- Zhvillimin e sportit te futbollit, nepermjet krijimit te ekipit te futbollit per te rritur dhe per te rinj, si dhe te ekipeve zinxhire , trainimin dhe stervitjen e tyre me te gjitha kushtet teknike dhe sipas parametrave kombetare dhe nderkombetare , trainimin ne to te sportisteve te rinj me Sportin e Fubollit
- Pjesmarrjen ne gara kombetare dhe nderkombetare te sportisteve te ketij Klubi, ne perputhje me legjisacionin shqiptar dhe rregullat e Federates Shqiptare te futbollit si dhe te Federates Nderkombetare te Futbollit,
- Arritjen e rezultateve te larta sportive , ngritjen e cilesise te sportit te futbollit, organizimin dhe pjesmarrjen ne garat sportive
- Kualifikimi i trainereve ne kursete ndryshme lidhur me metodat bashkohore dhe shkencore te sportit te Futbollit
- Permiresimin e kushteve te ambienteve sportive , krijimin e kushteve teknike per anetaret e klubit , trainimin e tyre , stervitjen dhe ngritjen e te dhenave sportive
- Krijimin e kushteve sanitare dhe shkencore, trajtimi i materialeve shkencore teknike dhe sportive per sportin e futbollit, kualifikimine futbollisteve
- Pjesmarrja ne projekte te ndryshme kombetare dhe nderkombetare me partner vendas dhe te huaj
- Bashkpunim me shoqeri dhe klube te tjera simotra brenda dhe jashte vendit



NENI 5



Selia e shoqerise eshte ne adresen Cerrik, prand Stadiumit Nexhip Trungu , Per komunikime zyrtare elektronike adresa elektronike e shoqerise do te jetet klubicerrrik@gmail.com

KREU II KAPITALI THEMELTAR

NENI 6

Kapitali themeltar I shoqerise eshte **100.000** (njeqind mijë) leke shqiptare.. Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane nenshkruar e shlyer krejtesisht e pastaj jane ndare ne **2 (DY) kuota** me vlerë nominale

a- Nje kuote ne vleren nominale **60.000**(gjashtedhjete mijë) leke shqiptare e cila eshte ne zoterim te ortakut **GENTJAN GJOKA**

b- Nje kuote ne vleren nominale **40.000** (dzyzete mijë) leke shqiptare , e cila eshte ne zoterim te ortakut **BASHKIA CERRIK**

NENI 7

Me vendimin e Asamblee se Ortakeve , kapitali I shoqerise mund te zmadhohet nepermjet kontributeve ne para ose ne natyre. Po keshtu mund te zvogelohet kur kjo gje motivohet nga humbjet qe peson shoqeria.

NENI 8

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashgimie, ne rast ndarje pasurore mes bashkeshorteve, ndermjet bashkeshorteve si dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

NENI 9

Pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen te treteve vetem me miratim te Asamblee se Ortakeve, pasi tu jene ofruar per shitje me pare ortakeve te shoqerise .Po keshtu shoqeria mund te perfshihet ne sht-blerej aksionesh me shoqeri te tjera duke u kthyer ne filial, shoqeri kontrolluese, ose e kontrolluar nga ndonje shoqeri tjeter.

NENI 10

Ne edo rast, transferimi te pjesave te kapitalit themeltar , duhet te vertetohet me nje akt notarial.

KREU III.

MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI, KOPETENCAT DHE KONTROLLI I SHOQERISE

NENI 11

Te gjitha vendimet e shoqerise merren nga Asamblea e Ortakeve duke u bazuar ne dispozitat ligjore te percaktuara ne ligjin “Per shoqerite Tregtare”ne lidhje me marrjen e vendimeve.Ajo vendos vete kryesisht per keto çeshtje:



- Merr vendime për ndryshimin e formës ,emërimit,selisë,kapitalit,veprimtarisë së shoqerisë,ndryshimin në zotërimin e kuotave të kapitalit të shoqërisë,pranim të ortakëve,pjesmarrjen e shoqërisë në shoqëri të tjera dhe anasjelltas.
- Miraton raportet financiare dhe bilancin vjetor ,vendos për përdorimin e fitimit ,organizimin e shoqërisë dhe prishjen e saj.
- Emëron dhe shkarkon administratorin, drejtuesin teknik,likuidatarin ,ekspertët kontabël si dhe drejton veprimtaritë e rëndësishme të shoqërisë.

Marrja e vendimeve realizohet sipas nenit 82-84 të ligjit 9901

NENI 12

Shoqëria administrohet nga një preson fizik,që mund të jetë një nga Ortakët ose një person tjetër i emëruar në këtë detyrë.

Administrator i shoqërisë është GENTJAN GJOKA për një periudhë për 1 VIT me të drejtë riemërimi ,me kushtin që brenda ketij afati te negociohet per mandatin më afat 5- vjeçar të administratorit.

Administratori ka të gjitha kopetencat për të kryer veprimet e administrimit ,në interes të shoqërisë dhe në emër të saj ,nëpërmjet kopetencave të përcaktuara në këtë statut.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Mandate përfundon përpara këtij afati kur administratori nuk plotëson kushtet për të kryer këtë detyrë ,jep dorëheqjen prej saj ,shkarkohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë ose nga një vendim gjykatë.

NENI 13

Administratori është përgjegjes ,sipas rastit,ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve ,për shkelje të ligjeve ,për shkelje të statutit,apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 14

Në përputhje me ligjin për ushtrimin e këtij aktiviteti ,shoqëria ka të drejtën e emerimit apo te shkarkimit të një drejtuesi teknik.

Drejtuesi teknik është drejtuesi më i lartë dhe është përgjegjësi ligjor për drejtimin,bashkërendimin dhe kontrollin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike ,pra të veprimtarisë së shoqërisë e përcaktuar sipas nenit 4 të këtij statusi.


Drejtuesi teknik i shoqërisë emërohet dhe shkarkohet me vendim nga Asambleja e Ortakëve.

NENI 15

Disa nga kopetencat që i jepen administratorit janë:

- Të siguroje drejtimin e mirë të veprimtarisë tregtare të shoqërisë.
- Të administrojë pasuritë e shoqërisë.
- Të përfaqesojë shoqërine në marrëdhëniet me të tretët.
- Të kryejë veprime juridike në emër e për llogari të shoqërisë me të tretet si: te lidhë kontrata ,të kryejë veprime bankare të ndryshme si celje llogarish,marrje kredije ,transferta etj.

Si dhe kopetencat e parashikuara nga ligji 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregëtarët e Shoqërisë Tregtare" i ndryshuar me ligjin 10475 dt.27.10.2011 dhe ligjin nr. 9723 dt, 03.05.2007 "Përgjegjësitë gendrën Kombetare të Rregjistrimit" si dhe në ligjet e tjera që lidhen me veprimtarinë tregtare në Republikën e Shqipërisë.



NENI 16

Kontrolli i veprimtarise ekonomiko-financiare te shoqerise realizohet nga nje ekspert kontabel i pavarur, i cili emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se Ortakeve .

KREU IV

VITI FINANCIAR DHE LLOGARITE VJETORE.

NENI 17.

Viti finanziar fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor.Perjashtimisht nga kjo viti i pare finanziar ka filluar diten e themelimit te shoqerise si person juridik.

NENI 18

Llogarite vjetore , inventaret, raportet mbi veprimtarine e viti finanziar te hartuara nga administratori dhe ekspert I kontabel I atorizuar, miratohen nga Asamblea e Ortakeve brenda nje afati prej 6-muaj nga mbyllja e vtit finanziar.

NENI 19.

Bilanci vjetor i veprimtarise nxirret mbrenda dates 31 mars te vtit pasardhes.

NENI 20

Fitimet neto te realizuara nga veprimtaria e shoqerise, mbasi te jene zbritur te gjitha shpenzimet e kryera , detyrimet fiskale, rezerva e domosdoshme etj, I shperndahen ortakut ose me vendim te tij mund te perdoren per investime, nxitjen e veprimtarise tregtare, reklame dhe per cdo qellim tjeter te ligjshem dhe qe I sherben shoqerise.

NENI 21

Shoqeria ka te drejten e perdonimit lirisht te fitimit dhe disponimit te pasurise se saj ne perputhje me qellimin e objekti te veprimtarise qe kryen.

NENI 22

Detyrimet qe mund te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise se shoqerise, ajo I mbulon nga fondi rezevre ose nga shuma suplementare.

NENI 23

Shoqeria gezon te gjitha te drejtat , per mbrojtjen e pasurise se saj, te parashikuara nga legjislationi shqiptar ne fuqi.

KREU V.

PUNESIMI NE SHOQERI



NENI 24

Marredhenet juridike mes shoqerise dhe personave qe punesohen ne te rregullohen nepermjet kontratave te punes, bazuar ne Kodin e Punes dhe dispozitat e tjera ligjore ne fuqi.

KREU VI.

PRISHJA E SHOQERISE LIKUJDIMI

NENI 25

Shoqeria prishet perpara kohe kur:

- Rezultati ekonomik I aktivitetit te saj per disa vite rrradhazi eshte me humbje
- Per shkaqe te parashikuara shprehimisht ne ligj
- Ne cdo rast tjeter me vendim te Asamblese se Ortakeve
- per cdo rast i parashikuar nga ligji dhe aktet nenligjore ne vijim

NENI 26

Shoqeria mund te shpallet ne likujdim me vendim te Asamblese se Ortakeve te saj , ose nepermjet nje vendimi nga gjykata ne baze te ligjit.

Ajo hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e marrjes se vendimit. Per realizimin e ketij procesi asamblea e Ortakeve ose gjykata emerojne nje ose me shume likujidatore, te cilet pregatisin dhe paraqesin raportin perbyllies te aktivit dhe pasivit te shoqerise dhe bilancin perkates.

KREU VII.

KUSHTE TE TJERA

NENI 27

Te gjitha vendimet e marra nga Asamblea e Ortakeve evidentohen ne nje liber te vecante, I cili administrohet ne seline e shoqerise.

Ne rast se ka ndryshim ortakesh atehere shoqeria detyrohet te kryeje cdo rregjitim prane QKB ne te kunder ai mban pergjegjesi sipas nenit 71 te ndryshuar te lifgjitet per QKB

NENI 28.

Per te gjitha mosmarrveshjet qe mund te lindin gjate veprimitarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim , organi kopet per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit ku ka seline shoqeria, referuar ne legjislacionin shqiptar ne fuqi.

PER SHOQERINE TREGTARE
"KLUBI I FUTBOLLIT "TURBINA" SH.P.K.
ORTAKET

